



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.880/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit T.SH. nga fshati ... Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson R.SH. avokat në Ferizaj, kundër të paditurit S.T. nga fshati ... Komuna e Shtimes, të cilin me autorizim e përfaqëson K.A. avokat në Ferizaj, në çështjen kontestimore me bazë juridike pagesa e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga i padituri kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.86/2016 të datës 15.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.01.2021 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit S.T. nga fshati ... Komuna Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.86/2016 i datës 15.11.2016, VËRTETOHET, përveç kamatës në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset DETYROHET i padituri që paditësit t'i paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 15.11.2016, e deri në pagesën definitive

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.86/2016 të datës 15.11.2016, ka vendosur si në vijim:

I.Aprovohet kërkesëpadia e paditësit T.SH. nga fshati ... Komuna Ferizaj, Detyrohet i padituri S.T. nga fshati ... Komuna e Shtimes që paditësit t'ia paguaj

shumën prej 2000€ (dymijë euro) në emër të pagesës së borxhit për çmimin kontraktues për veturën e markës Volkswagen, tipi transportues viti i prodhimit 1991, me kamatë ligjore (8%), si për mjetet e deponuara në bankë për një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 13.03.2008, deri në pagesën definitive, si dhe shumën prej 40€, në emër të shpenzimeve të procedurës, të gjitha në afatin prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Obligohet pala e paditur që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës palës paditëse në shumën prej 270.40€, për përfaqësime në seancat e mbajtura.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, apo aktgjykimi të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi T.SH. nga fshati ... Komuna Ferizaj, me datë 13.03.2008, në Gjykatën Komunale në Ferizaj, ka paraqitur padi për pagesën e borxhit kundër të paditurit S. A. T. nga fshati ... Komuna Shtime, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata Komunale në Ferizaj me aktgjykimin C.nr.116/08 të datës 11.12.2012, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa aktgjykimi në fjalë, sipas ankesës së të paditurit është prishur nga Gjykata e Apelit (shih aktvendimin Ac.nr.333/2013, dt. 15.01.2016) dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, me udhëzimet që të vërtetohet drejtë gjendja faktike, ashtu që veç tjerash gjykata t'i dëgjoj ndërgjyqësit në cilësi të palës.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë ka zhvilluar procedurën për administrimin e provave. Me vlerësimin e pretendimeve të ndërgjyqësve dhe të provave të nxjerra, gjykata e çështjes gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e aprovoi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka theksuar se për të vërtetuar gjendjen faktike bëri leximin dhe administrimin e provave dhe duke i shtjelluar dhe analizuar dëshmitë e dëshmitarëve M. I. dhe A. N.. Mirëpo, duke pasur parasysh se

dëshmitarët kanë qenë punëtorë të të paditurit dhe tek të njëjtit është vërejtur subjektivizëm i theksuar me rastin e deklarimit, prandaj deklaratat e tyre nuk i pranoi si prova të besueshme. Mëtuqje ka theksuar se i padituri nuk ka propozuar ndonjë provë me të cilën do ti mbështeste pretendimet e tija se ka paguar pjesërisht borxhin – objekt kërkesëpadie. Sipas vlerësimit të gjykatës ka qenë obligim i të paditurit (pasi që i njëjti është edhe afarist), që me pagimin eventuale të borxhit, të lëshonte ndonjë dëshmi me shkrim, ashtu siç është vepruar me lidhjen e marrëveshjes për shitblerjen e automjetit. Gjykata vendimin për aprovimin e kërkesëpadiës e mbështeti në dispozitat e nenit 516 dhe 324 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Për kamatën vendosi në kuptim të nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në nenin 452.1 Të LPK-së

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë (përveç kamatës), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese në ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadiës. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, pasi gjykata është fokusuar në vërtetimin e fakteve të pohuara nga palët ndërgjyqëse dhe atë mbi bazën e provave të prezantuara nga vetë palët. Për më shumë, i padituri nuk ka provuar se pas marrëveshjes për shitblerjen ka pasur ndonjë vërejtje lidhur me automjetin – objekt shitblerjeje dhe që eventualisht kundërshtimet e tija t'i ketë paraqitur shitësit (këtu paditësit) e që do të ishte me ndikim për të vendosur përkitazi me kërkesëpadiën, gjersa prezantimi i fakteve të reja, në kuptim të nenit

180 par 1 të LPK-së, nuk mund të mirren parasysh nga gjykata ankimore, përderisa palët në asnjë mënyrë nuk ka qenë të penguar që provat t'i paraqesin gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim, gjykata përkujton se i padituri ndonëse ishte i njoftuar me vendimin për t'u dëgjuar në cilësinë e palës, i njëjti, nuk është paraqitur në seancën e shqyrtimit kryesor dhe që në këtë situatë dhe me qëllim të moszvarritjes së procedurës, paditësi kishte revokuar propozimin për dëgjimin e të paditurit në cilësi të palës.

Vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë e gjykuar të detyrimit, e pranon si të rregullt edhe gjykata ankimore për arsye se detyrimi i të paditurit është vërtetuar me prova konkrete të administruara me ndërgjegje nga gjykata. Në këtë kuptim baza juridike e kërkesëpadisë gjen mbështetje në dispozitën nga neni 262 par 1 të LMD-së, ku parashihet autorizimi i kreditorit që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, respektivisht detyrimi i debitorit që detyrimin në përmbajtjen e tij, ta përmbushë në tërësi dhe me ndërgjegje. Prandaj, nga arsyet e parashtruara Gjykata e Apelit ripërsëritë se përkrahë në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm vendimin lidhur me çështjen kryesore, gjersa për pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me kamatën vlerëson se vendimi është nxjerrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 277 të LMD, për faktin se gjykata nuk ka marrë për bazë kërkesën ligjore nga kjo dispozitë, ku përcaktohet se kamata paguhet si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit siç e aplikojnë bankat afariste në Kosovë. Prandaj nga kjo arsye, kolegji i kësaj gjykate aktgjykimin në këtë pjesë e ndryshoi, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ankimore i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore por nuk i ka gjetur si të themelta për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Mbi bazën e arsyeve të parashtruara si më lartë dhe në mbështetje të nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 dhe 201 par 1 pika d), të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.880/17, me datë 12.01.2012

Kryetare e kolegjit  
Hunaida Pasuli